



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. 21166/5 Prot.,

Shkodër, më 16.09.2026

KONTRATË - KOLAUDIMI
REF-97982-08-28-2026

**Kolaudim i punimeve per objektet: Rikonstruksion rruge dhe Rikualifikim urban
blloqe banimi (Rruga ‘Pjetrush’i” pranë varrezave të qytetit Grudë e Re)**


E lidhur sot me datë ____/____/2026, midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër, e përfaqësuar nga **Z. Benet Beci** në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Shkoder i përfaqësuar ne kete kontrate me Vendim Delegimi nga **Z. Alban Preka** në cilësinë e Zv/Kryetarit të Bashkisë Shkodër që në vijim do të quhet **Autoriteti Kontraktor**.

Dhe Operatorit ekonomik **Daniela Lleshaj Person Fizik (P.F)** e paisur me liçencën përkatëse me **nr. MK. 4327/1 date 31.10.2025** leshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise, **nr NUIS M41508003F**, regjistruar me regjistrim fillestar nr. CN-261892-03-24 me adrese: Tirane Rruga Jordan Misja, Pallati Reno Construction, Shkalla 1, Apartamenti 4, perfaqesuar nga Administratori **zj. Daniela Lleshaj** me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe kompetencë të plotë për te përfaqësuar shoqërinë, në të gjitha marrdhëniet që burojnë prej kësaj kontrate me autoritetin Kontraktor, Bashkia Shkoder për realizimin e objektit të kontratës. Në vijim do të quhet **”Kontraktuesi” (Kolaudatori i Punimeve)**

OBJEKTI I KONTRATËS: Kolaudim i objektit: Sistemim asfaltim rruga ‘Pjetrush’i” pranë varrezave të qytetit Grudë e Re.

BAZA LIGJORE :

- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,
- Ligji nr. 8402 datë 10.09.1998, kreu III, neni 12,15 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (i ndryshuar),
- VKM nr. 285, datë. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar,
- Vendim nr. 354 date 11.05.2016 ‘Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Teritori,Projektim,Mbikqyerje dhe Kolaudim”,
- Vendimin Nr. 610, datë 22.9.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij,kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”
- Ligji nr.48/2014 ”Per pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore e tregtare” i ndryshuar.



NENI 1

Vlefte e kontratës

- 1.1 Kontrata lidhet për vleftën prej **13,179.00** (trembëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh.
- 1.2 Financimi realizohet nga Buxheti i Bashkisë Shkodër.
- 1.3 Çmimet e kontraktorit për shërbimet e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

NENI 2

Afati i kontratës

- 2.1 Kontrata do të realizohet për 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të saj.
- 2.2 Çdo ndryshim i urdhëruar nga investitori i cili sjell shtyrjen e afatit të kontratës, do të jetë detyruesht objekti i një proces-verbali me shkrim i mbajtur ndërmjet investitorit dhe kolaudatorit apo grupit të kolaudimit.

NENI 3

Gjuha e kontratës

Gjuha e kontratës është gjuha shqipe.

NENI 4

Komunikimi ndërmjet palëve

Komunikimi ndërmjet palëve duhet të bëhet vetëm me shkrim. Njoftimi bëhet efektiv vetëm pasi dorëzohet.

NENI 5

Raste të kompensuara

Raste të kompensuara për të cilat vonesa justifikohet do të konsiderohen si vijon :

- a- Autoriteti kontraktor nuk dorëzon në kohë dosjet e zbatimit dhe të mbikqyerjes së punimeve.
- b- Autoriteti kontraktor vonon pagesën për likuidimin e vlerës së kontraktuar të procesit të kolaudimit për shkak të mos çeljes së fondeve përkatëse menjëherë pas kryerjes së procesit të kolaudimit.
- c- Kolaudatori apo grupi i kolaudimit vonon përfundimin e procesit të kolaudimit kur konstaton defekte në plotësimin e dokumentacionit të dosjeve të zbatimit dhe të mbikqyerjes së punimeve.
- d- Kolaudatori apo grupi i kolaudimit caktohet që në fillim të punimeve me detyrimin që të bëjë kontrolle të vazhdueshme gjatë zbatimit të punimeve.
- e- Për dy pikat e fundit “c” e “d”, investitori do të njohë edhe shpenzimet suplementare eventuale.

NENI 6

Detyrimet e përgjithshme të kontraktuesit

Për kolaudatorin apo grupin e kolaudimit :

1- Duhet të verifikojë me përgjegjësi :

a)-Realizimin e objektit në përputhje me projektin dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori,para dhe gjatë zbatimit,lejen e ndërtimit,standardet e rregullat teknike.



b)-Realizimin e objektit në përputhje me kontratat e sipërmarrjeve të zbatimit dhe të mbikqyrjes së punimeve.

c)-Përputhjen e dokumentave me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.

d)-Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar të kontratës së sipërmarrjes së zbatimit të punimeve me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse në rastet e mospërputhjes.

2- Kur vërehen defekte në verifikimet e bëra, kolaudatori apo grupi i kolaudimit lë detyra me shkrim për punimet që duhet të kryhen, duke përcaktuar afatet e përfundimit të tyre, në mënyrë që të plotësohen të gjitha kushtet e parashtruara në pikën "1". Në varësi nga natyra e defekteve të percaktohen detyrimet e secilës palë.

3- Të kontrollojë në se çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës. Në se vërehen ndryshime të përlogaritit efekti ekonomik.

4- Në përfundim të kolaudimit të objektit duhet të hartojë proces-verbalin e kolaudimit, i cili firmoset nga kolaudatori apo grupi i kolaudimit, nga sipërmarrësi dhe nga mbikqyrësi i punimeve. Proces verbalit duhet të përmbajë të plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në akt kolaudimit (i një vlefshëm me proces verbalin) bashkëngjitur kësaj kontrate.

5- Procesverbalit mbahet në 4 kopje, dy nga të cilat i dërgohen Bashkisë Shkoder dhe pas regjistrimit i dërgohet investitorit. Një kopje e proces verbalit i jepet mbikqyrësit të punimeve, i cili përcakton vlerën përfundimtare të objektit.

NENI 7

Të drejtat dhe detyrimet e Autoritetit Kontraktor

Për autoritetin kontraktor Bashkia Shkodër:

- 1- Duhet të përcaktojë në marrëveshje me mbikqyrësin e punimeve dhe kolaudatorin apo grupin e kolaudimit mënyrën dhe afatet e procesit të kolaudimit.
- 2- I dorëzon kolaudatorit apo grupit të kolaudimit dosjet e zbatimit dhe të mbikqyrjes së punimeve menjëherë pas daljes së urdhërit të brendshëm për emërimin e kolaudatorit apo grupit të kolaudimit dhe çeljes së fondeve.
- 3- Bën pagesën sipas vlerës së kontratës menjëherë pas dorëzimit të aktit të kolaudimit të rregjistruar më parë në Bashkinë Shkodër, bashkëngjitur lejen përkatëse të shfrytëzimit të objektit.

NENI 8

Kushtet e pagesës

- 8.1 Pagesa për Shërbimet duhet bërë sipas skedarit të mëposhtëm: Pas nënshkrimit mes palëve të certifikatës së përkohshme të marrjes në dorëzim të punimeve.
- 8.2 Çdo pagesë e skeduar duhet bërë brenda 30 ditëve nga data e arritjes së marrëveshjes për pagesën ose nga data e marrjes së kërkesës me shkrim për pagesë cilado që të jetë më vonë. Nëse është lënë e paplotësuar, periudha kohore do të jetë 30 ditë.
- 8.3 Monedha e pagesës do të jetë Lek. Nëse është lënë e paplotësuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.

NENI 9

Vonesa në bërjen e pagesës



9.1 Sipërmarrësi (kolaudatori apo grupi i kolaudimit) do ti paguaj investitorit dëmshpërblimin për vonesa për kryerjen e procesit të kolaudimit (me perjashtim të rasteve të kompensuara), në masën 0,1% të vlerës së kontratës për çdo ditë vonese tej afatit të përcaktuar në kontratë.

9.2 Sasia e përgjithshme e dëmshpërblimit për vonesa në kryerjen e procesit të kolaudimit nuk duhet të kalojë masën prej 25% të vlerës së kontratës, në të kundërt përveç ndalesës së bërë në vlerën e përcaktuar në kontratë prej 25% të vlerës së saj do ti propozohet IMT Shkodër, për vendosje gjobe në masën konform nenit 15 të ligjit të mësipërm.

9.3 Investitori do ti paguaj sipërmarrësit (kolaudatorit apo grupit të kolaudimit) 0,1% në ditë të vlerës së përgjithshme të kontratës për vonesat në pagesë kur kjo nuk likujdohet për faj të tij.

NENI 10

Përgjegjësia e përbashkët dhe solidare

10.1 Nëse Furnizuesi është një bashkim i Operatorëve Ekonomikë, të gjithë këta Operatorë Ekonomikë do të jenë bashkërisht dhe solidarisht përgjegjës ndaj Blerësit për përmbushjen e dispozitave të Kontratës.

10.2 Subjekt mbështetës do të jetë operatori ekonomik **MIKI CONSULTING SHPK NUIS K87628701K**, regjistruar me regjistrim fillestar me CN-122796-02-08 me adresë: Shkoder Qendra "Skodrinon", Rruga "Vaso Kadia", Nr. 2. e perfaqesuar nga Administratori **z. Gjeto Dukaj** me licencën përkatëse me **nr. MK. 1503/08 datë 29.07.2026** me afat vlefshmërie deri me 12.05.2031 lëshuar nga Ministria e Infrastrukures dhe Energjise.

NENI 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Investitori dhe sipërmarrësi (kolaudatori apo grupi i kolaudimit) do të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që lind gjatë realizimit të kësaj kontrate, në rast të kundërt palët i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

NENI 12

Vlefshmeria e kontratës

Kjo kontratë hartohet në 5 (pesë) kopje dhe quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët kontraktuese.

AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA SHKODER

Përfaqësuar me vendim delegimi

Zv/Kryetar i Bashkisë

Alban PREKA



PER OPERATORIN EKONOMIK

Daniela Lleshaj P.F

Administratori

Daniela LLESHAJ

